



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 12.09.2024

Nr: 21

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

MOSPRANIMIN PËR SHOYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 12, DATË 10.9.2024 TË DEPOZITUAR NGA Z. ASTRIT FADIL KAZIU

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.09.2024, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES:

Astrit Fadil Kaziu, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak Peqin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë.

OBJEKT:

Kundërshtim i vendimit të KQZ i datës 13.08.2024, në lidhje me caktimin e shtetases Donika Ded Karina si anëtare e Këshillit Bashkiak, Peqin, nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor

BAZË LIGJORE:

Nenet 21 pika 1 shkronja “b”, 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Data: 12.09.2024

Nr: 21
Ora: 14:00



Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 12, datë 10.09.2024 të depozituar nga z. Astrit Fadil Kaziu

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Z. Astrit Fadil Kaziu ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 12 regj., datë 10.09.2024.

Në mbledhjen e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve të datës 02.08.2024, pas relatimit të anëtarit z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenet 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte në mbështetje të nenit 129 të Kodit Zgjedhor si edhe të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

Kërkesa Ankimore e depozituar është pa objekt pasi nga verifikimi i bërë në seancë nuk rezulton të ketë një vendim apo një akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) të marrë në datën e pretenduar, i cili të mund të shqyrtohet nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) në kuptim të parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Në interpretim të ankimit të paraqitur nga z. Kaziu rezulton se ai pasi është vënë në dijeni me shkresën nr. 2456, datë 13.8.2024 të KSHZ drejtuar zj. Donika Karina dhe duke mos qenë dakord me faktin që mandati i këshilltarit bashkiak ti kalojë asaj (zj. Karina) i është drejtuar KAS me ankimin objekt shqyrtimi. Argumenti përse ankimesi ka paraqitur këtë ankim është fakti se ai pretendon që mandati i këshilltarit bashkiak në këtë rast duhet t'i kalonte atij pasi në listën shumemërore të Partisë Socialiste ai mban numrin 10, ndryshe nga zj. Karina e cila mban numrin 13 në atë listë.

Pavarësisht faktit se ankimi në fjalë është pa objekt dhe si i tillë nuk mund të meret në shqyrtim nga KAS, ky i fundit vlerëson se ankuesi ka një interes të ligjshëm në pretendimin e paraqitur prej tij. Në këto kushte, KAS i rekomandon administratës së KQZ-së të njoftojë z. Astrit Fadil Kaziu për të qenë prezent në procedurën që do të zhvillohet nga KSHZ për plotësimin e vakacës në Këshillin të Bashkisë, Peqin, në mënyrë që të ketë mundësi të parashtrijë dhe të dëgjohet mbi kërkesat dhe pretendimet e tij për këtë çështje.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

Data: 12.09.2024 Nr: 21
Ora: 14:00



Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 12, datë 10.09.2024 të depozituar nga z. Astrit Fadil Kaziu

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 12, datë 10.09.2024, të z. Astrit Fadil Kaziu;

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 12.09.2024.

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar